

FESTIVALI
KOMBËTAR
I EDICIONI 14
FILMIT
SHQIPTAR

Ju lutem, m'i vadisni filizat!

Dhimitër Anagnosti



QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

ALBANIAN NATIONAL CENTER OF CINEMATOGRAPHY

www.qkk.al

FESTIVALI KOMBËTAR
I FILMIT SHQIPTAR

EDICIONI
I 14-TË

TIRANË
— 2026

THE NATIONAL
ALBANIAN FILM FESTIVAL

THE 14TH
EDITION

TIRANA
— 2026

ILIR BUTKA

Drejtor Artistik

Të dashur kineastë, artdashës dhe miq të ekranit të madh,
mirë se vini në Edicionin e 14të të Festivalit Kombëtar të Filmit Shqiptar!

Po të përdorja një metaforë, ky edicion do të ishte përpjekja jonë e guximshme për të "futur një elefant në shishe"—një sfidë e bukur për të përmbledhur 14 vite krijimtarie, pasioni dhe përkushtimi kinematografik në vetëm dhjetë ditë festë të artit.

Në një kohë kur tregu global dominohet nga makineritë e fuqishme të promovimit të kinemasë komerciale—ku investimet marramendëse të marketingut eklipsojnë shpesh prodhimin evropian dhe atë lokal—pyetja që dëgjojmë më shpesh është: Bëhen ende filma në Shqipëri?

Përgjigjja qëndron pikërisht këtu. Në këtë pabarazi tregu, festivalet e filmit mbeten oaze të vetme funksionale, ku filmi i mirë *art house* merr frymë dhe ku rivendoset kontakti me spektatorin. Festivali Kombëtar mbetet ura më e rëndësishme, ku publiku i apasionuar takon estetikën dhe narrativën e filmit shqip, duke rijetësuar atë marrëdhënie të shumëpritur mes ekranit dhe shikuesit tonë.


Në këtë edicion kemi zgjedhur të zhvendosim vëmendjen te krijuesit e padukshëm. Në kinemanë e autorit është regjisori ai që i jep shpirt dhe vizion veprës. Ndaj, ky edicion i kushtohet regjisorit shqiptar dhe producentëve—arkitektëve të filmave tanë. Prania e tyre fizike gjatë këtij edicioni do të shërbejë si një ftesë e hapur për të ndërtuar një dialog të drejtpërdrejtë e personal mes filmbërësve dhe publikut.

Një thirrje e veçantë u shkon të rinjve. Dëshirojmë që audienca e këtij edicioni të mbushet me rininë tonë, e cila ka nevojë të zbulojë dhe të kuptojë më shumë nga kinematografia e viteve të fundit—e pse jo, të frymëzohet për t'u bërë pjesë e së ardhmes së saj.

Së fundmi, me përulësi dhe respekt të thellë, këtë edicion ia kushtojmë edhe brezit të vjetër, mjeshtrave që na lanë trashëgim një kinematografi me vlera të pamohueshme. Do të nderojmë me Çmimin e Karrierës ata që i dhanë jetë këtij arti, si dhe do të kujtojmë me nostalgji e mirënjohje të gjithë ata që sot nuk janë më mes nesh, por që do të jetojnë përgjithmonë përmes veprës së tyre.

Ju ftoj të përjetojmë së bashku këtë festë të kinemasë shqiptare!

Artistic Director



Dear filmmakers, art lovers and friends of the big screen,
welcome to the 14th Edition of the Albanian National Film Festival!

If I were to use a metaphor, this edition would be our bold attempt to "put an elephant in a bottle"—a beautiful challenge to compress 14 years of cinematic creativity, passion and dedication into just ten days of art celebration.

At a time when the global market is dominated by the powerful machinery of commercial cinema promotion—where massive marketing investments often eclipse European and local production—the question we hear most often is: Are films still being made in Albania?

The answer lies right here. In this market inequality, film festivals remain the only functional oases where good art house film breathes and where contact with the audiences is restored. The National Festival remains the most important bridge where the passionate public meets the aesthetics and narrative of Albanian film, reviving that long-awaited relationship between the screen and our viewer.

In this edition, we have chosen to shift our attention to the invisible creators. In auteur cinema, it is the director who gives soul and vision to the work. Therefore, this edition is dedicated to the Albanian director and producers—the architects of our films. Their physical presence during this edition will serve as an open invitation to build a direct and personal dialogue between filmmakers and the public.

A special call goes out to the young. We want the audience of this edition to be filled with our youth, who need to discover and understand more of the cinema of recent years—and why not, be inspired to become part of its future.

Finally, with deep humility and respect, we dedicate this edition to the older generations, to the masters who left us a legacy of filmmaking with undeniable value. We will honor with the Career Award those who gave life to this art, and we will remember with nostalgia and gratitude all those who are no longer with us today, but who will live on forever through their work.

I invite you join us in experiencing this celebration of Albanian cinema together.

Dr. RAFAELA RICA

Producente

Të dashur miq të filmit,

Në shumë vite punë kam pasur privilegjin të organizoj qindra evente, por kam kuptuar se ka disa ngjarje që shkojnë përtej një organizimi. Ato mbartin një përgjegjësi, një emocion dhe një rëndësi të veçantë.

Për mua, Festivali Kombëtar i Filmit Shqiptar është një prej tyre.

Rikthimi i tij pas 14 vitesh mungesë nuk është thjesht rikthimi i një festivali. Është rikthimi i një hapësire që kinemaja shqiptare e meriton dhe i një takimi që i ka munguar filmit, kineastëve dhe publikut.

Jetojmë në një kohë kur konsumojmë më shumë informacion se kurrë — gjithçka është e shpejtë, e menjëhershme dhe shpesh komerciale. Pikërisht sot kemi edhe më shumë nevojë për filmin e vërtetë: për historitë që kanë diçka për të thënë, që na bëjnë të mendojmë dhe të ndiejmë.

Mirënjohja ime më e madhe shkon për kineastët shqiptarë, të cilët edhe gjatë viteve kur festivali mungoi, vijuan të krijonin, shpesh me mundësi të kufizuara dhe me sakrifica të panumërta. Ky festival, para së gjithash, është për ta.

Për ne rikthimi pas 14 vitesh është privilegj, por edhe përgjegjësi: të respektojmë historinë e festivalit, t'i japim një identitet që i përket kohës sonë dhe, mbi të gjitha, të lëmë pas një standard të lartë dhe një vazhdimësi.

Le të mos jetë ky vetëm një rikthim;
Le të jetë një fillim, që këtë herë, rrugëton!

Producer



Dear film friends,

Over many years of work, I have had the privilege of organizing hundreds of events, but I have realized that some go beyond mere logistics. They carry a unique responsibility, deep emotion, and lasting importance.

To me, the Albanian National Film Festival is one of them.

Its revival is far more than the comeback of a film festival. It restores a vital space that Albanian cinema truly deserves — a long-awaited reunion for filmmakers and audiences alike.

We live in an era where we consume content faster than ever, yet much of it is purely commercial. Today, more than ever, we need authentic cinema: stories with purpose that challenge us to think and feel.

My deepest gratitude goes to Albanian filmmakers who, even during the fallow years, continued to create despite limited opportunities and immense sacrifices. This platform, first and foremost, belongs to them.

For us, orchestrating this revival is both a privilege and a profound responsibility. We aim to honor its history, shape an identity that reflects our modern era, and, above all, establish a benchmark for its future continuity.

Let this be more than a temporary return.
Let it be a new beginning—one that, this time,
carries the journey forward.

JONID JORGJI

Kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë

Të nderuar artdashës, krijues, kineastë dhe miq të mirëpritur të ekranit të madh, pas plot 14 vitesh mungesë, Festivali Kombëtar i Filmit Shqiptar rikthehet zyrtarisht aty ku ka vendin e nderit!

Katërmbëdhjetë vjet janë një kohë e gjatë për të pritur, aq e gjatë sa një brez i tërë kineastësh të rinj, sot të suksesshëm, herën e fundit në këtë festival ishin akoma studentë, dhe ku shumë nga kineastët që konkurronin asokohe, sot, për fat të keq, janë ndarë nga kjo jetë. Por kjo periudhë e gjatë heshtjeje nuk e zbehu dëshirën tonë për t'u mbledhur rreth tregimeve tona, përveçse ndoshta na bëri pak më shijues e më kërkues secilin prej nesh kur ulemi në sallën e errët të kinemasë!

Mbi të gjitha, ky rikthim vjen në një moment të jashtëzakonshëm e vendimtar për kinematografinë tonë. Sot po jetojmë një kthesë historike në mënyrën se si e mendojmë, e prodhojmë dhe e kuptojmë filmin. Kinemaja shqiptare po shkëputet një herë e mirë nga mendësia e vjetër e izolimit, e ankesave kronike apo e stilit nostalgjik, për t'i lënë vend një mentaliteti të ri, ambicioz, modern, i hapur ndaj botës dhe i orientuar nga standardet më të larta ndërkombëtare.

Në faqet e këtij katalogu do të gjeni pjekurinë e mjeshtërve tanë me energjinë guximtare të një brezi që nuk kërkon më ndjesë për të treguar histori me zë të lartë. Filmat e këtij edicioni dëshmojnë se tregimet tona nuk janë më vetëm lokale, por flasin me një gjuhë universale, plot dinjitet dhe vizion bashkëkohor.

Ky festival nuk është thjesht një hapësirë, ku do të ndajmë çmime e ku do të "qortojmë" filmat e kolegëve pas çdo premiere, por një vatër ku po konsolidohet një frymë e re bashkëpunimi, edukimi dhe zhvillimi për të gjithë industrinë tonë audiovizuale.

Ju ftoj të shijoni çdo minutë të këtij udhëtimi magjik dhe të festojmë së bashku këtë epokë të re të ekranit tonë të madh!

Jetë të gjatë kinemasë së re shqiptare!
Ju faleminderit!

Head of the
National Center
of Cinematography



Dear art lovers, creators, filmmakers, and friends of the silver screen, after a whole 14 years of absence, the National Albanian Film Festival officially reclaims its rightful place of honor.

Fourteen years is a long time to wait—so long that an entire generation of young filmmakers, who are successful today, were still students the last time this festival took place, and many of the filmmakers competing back then have, unfortunately, now departed from this life. Yet, this long period of silence did not dim our desire to gather around our stories; if anything, it has perhaps made each of us a bit more appreciative and demanding whenever we sit in the dark cinema auditorium!

Above all, this return comes at an extraordinary and decisive moment for our cinema. Today, we are living through a historic turning point in the way we think about, produce, and understand film. Albanian cinema is breaking away once and for all from the old mindset of isolation, chronic complaints, or nostalgic styles, to make room for a new mentality: ambitious, modern, open to the world, and oriented toward the highest international standards.

Within the pages of this catalog, you will find the maturity of our masters blended with the bold energy of a generation that no longer apologizes for telling stories out loud. The films of this edition prove that our narratives are no longer just local, but speak a universal language, full of dignity and a contemporary vision.

This festival is not merely a space where we will hand out awards and where we will “critique” our colleagues’ films after every premiere, but a hearth where a new spirit of collaboration, education, and development is consolidating for our entire audiovisual industry.

I invite you to enjoy every minute of this magical journey and to celebrate together this new era of our silver screen!

Long live the new Albanian cinema!
Thank you!

Stafi i festivalit

ILIR BUTKA

Drejtor Artistik
Artistic Director

RAFAELA RICA

Producente
Producer

ERBLINA ASHIKU

Drejtore Ekzekutive
Executive Director

STELA URUÇI

Drejtore Finance
Chief Financial Officer

ORNELA ISLAMI

Drejtore e Komunikimit
Director of Communications

EDVIN QEFALIA

Drejtor Kreativ
Creative Director

PROJECT GRAPHICS

Krijues i Identitetit të Festivalit
Festival Brand Identity Creator

ERA IMERI

Menaxhere e Marketingut Digjital
Digital Marketing Manager

BIG MEDIA EXPERT

IT dhe Zhvillim Web
IT & Web Development

EGON MUSLIU

Drejtor i Fotografisë
Director of Photography

MARLIND SHIJAKU

Operator i Kamerës
Camera Operator

ANDI KOTRI

Dizajner Grafik
Graphic Designer

Festival staff

ICEBERG DECORATION

Menaxher i Eventeve
Event Managment

ARBANA RICA

Menaxhere Eventi
Event Manager

OLTJON GOLEMI

Inxhinier
Engineer

DHURTA MUÇAJ

Financiere
Finance

GENC OSMANI

Dizajner Grafik
Graphic Designer

KLAUDIA MIJA

Menaxhere e Prokurimeve
Procurement Manager

GLORIA VELIU

Asistente Ekzekutive
Junior Executive Assistant

MARTI KASMI

Konsulent Kreativ
Creative Consultant

11 STUDIO

Studio Dizajni
Design Studio

ENI ZEQIRI

Specialist PR
PR Specialist

EMA OSMANI

Koordinatore e Festivalit
Festival Coordinator

GERI KOLGEGA

Koordinator Teknik
Technical Coordinator

Struktura e Vlerësimit të Filmave

Festivali bazohet në tri sisteme të pavarura vlerësimi, ku secili ofron një perspektivë të veçantë dhe gjykim të ndryshëm:

JURIA ZYRTARE

Vlerëson vetëm filmin që autori e përzgjedh si veprën e tij më të mirë dhe përfaqësuese.

Rregulli i veçantë i këtij edicioni: Për shkak të akumulimit 14-vjeçar të produksioneve, të gjithë filmat e regjisorëve pjesëmarrës do të shfaqen në festival, por secili regjisor duhet të përzgjedhë vetëm një film për konkurrim zyrtar.

VLERËSIMI I AKADEMISË SË FILMIT

Ofron një gjykim gjithëpërfshirës, ku kineastët vlerësojnë të gjithë filmat pjesëmarrës në festival, pa kufizim mbi numrin e filmave për regjisor.

VOTA E PUBLIKUT

Ndjek të njëjtin parim me Akademinë: publiku ka mundësi të votojë dhe të vlerësojë çdo film që shfaqet në festival.

Përjashtimet nga konkurrimi: Të vetmit filma që nuk futen në garë për asnjë nga të tria sistemet e vlerësimit janë filmat e Programit Special, të cilët nuk janë të financuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë në periudhën 2013–2026.

How Films Are Evaluated

The festival is built on three independent evaluation systems, each offering a distinct perspective and a diversified judgment:

OFFICIAL JURY

Evaluates only the film that the author selects as their best and most representative work.

Special rule for this edition: Due to the 14-year accumulation of productions, all films by participating directors will be screened at the festival, but each director must select only one film to compete for the Official Jury.

FILM ACADEMY EVALUATION

Offers a comprehensive judgment where filmmakers evaluate all participating films, with no limit on the number of films per director.

AUDIENCE VOTE

Follows the same principle as the Academy: the audience can vote for and evaluate every film screened at the festival.

Exclusions from Competition: The only films not entering competition under any of the three evaluation systems are the Special Programme films, which are not funded by the National Film Centre in the 2013–2026 period.

Juria

Çmimet artistike kryesore ndahen nga katër juri të pavarura, secila e specializuar në një kategori filmi.

JURIA E FILMIT
TË GJATË ARTISTIK

Filmi më i Mirë i Gjatë i Karrierës
Filmi më i Mirë i Gjatë / Vepër e Parë
Çmimi për Skenarin më të Mirë
Çmimi për Muzikën më të Mirë
Çmimi për Aktoren më të Mirë
Çmimi për Aktorin më të Mirë
Çmimi për Drejtorin më të Mirë të Fotografisë
Çmimi për Producentin më të Mirë
Çmimi për Aktorin më të Mirë

JURIA E FILMIT
TË SHKURTËR

Filmi më i Mirë i Shkurtër

JURIA E FILMIT
DOKUMENTAR

Filmi më i Mirë Dokumentar

JURIA E FILMIT
TË ANIMUAR

Filmi më i Mirë i Animuar

Përjashtimet nga konkurrimi: Të vetmit filma që garojnë në të tria sistemet e vlerësimit janë filmat e Programit Special, të cilët nuk janë të financuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë në periudhën 2013–2026.

The Jury

The main artistic awards are presented by four independent juries, each specialised in a film category.

FEATURE
FILM JURY

Best Feature Film
Best Debut Feature Film
Best Screenplay
Best Music
Best Actress
Best Actor
Best Cinematography
Best Producer
Best Actor

SHORT
FILM JURY

Best Short Film

DOCUMENTARY
FILM JURY

Best Documentary
Feature Film

ANIMATED
FILM JURY

Best Animated Feature

The juries reserve the right to withhold awards when they do not deem them justified, and may propose additional awards with the approval of the festival director.

“Akademia” dhe Votimi i Profesionistëve

ÇMIME TË VOTUARA NGA ANËTARËT PROFESIONISTË TË AKADEMISË SË FESTIVALIT

Çmimi për Regjisorin më të Mirë
Çmimi për Aktoren më të Mirë
Çmimi për Aktorin më të Mirë
Çmimi për Aktoren më të Mirë Mbështetëse
Çmimi për Aktorin më të Mirë Mbështetës
Çmimi për Skenarin më të Mirë
Çmimi për Muzikën më të Mirë
Çmimi për Skenografinë dhe Vendet e Xhirimit
Çmimi për Filmin më të Mirë të Shkurtër
Çmimi për Filmin më të Mirë të Animuar
Çmimi për Producentin më të Mirë
Çmimi për Drejtorin më të Mirë të Fotografisë
Çmimi për Montazhin më të Mirë
Çmimi për Kostumet më të Mira
Çmimi për Filmin më të Mirë Dokumentar

“The Academy” and Professionals’ Vote

AWARDS VOTED BY THE PROFESSIONAL MEMBERS OF THE FESTIVAL ACADEMY

Best Director
Best Actress
Best Actor
Best Supporting Actress
Best Supporting Actor
Best Screenplay
Best Music
Best Production Design & Locations
Best Short Film
Best Animated Feature
Best Producer
Best Cinematography
Best Editing
Best Costume Design
Best Documentary Feature Film

Çmimi i Publikut

Çmime të vendosura drejtpërdrejt nga vota e publikut për secilën kategori filmi.

Çmimi i Publikut
Filmi më i Mirë i Gjatë i Karrierës

Çmimi i Publikut
Filmi më i Mirë i Gjatë / Vepër e Parë

Çmimi i Publikut
Filmi më i Mirë i Shkurtër

Çmimi i Publikut
Filmi më i Mirë i Animuar

Çmimi i Publikut
Filmi më i Mirë Dokumentar

Audience Award

Awards decided directly by the audience vote in each film category.

Audience Award
Best Feature Film

Audience Award
Best Debut Feature Film

Audience Award
Best Short Film

Audience Award
Best Animated Feature

Audience Award
Best Documentary Feature Film

Akademia Shqiptare e Kinematografisë

Akademia Shqiptare e Kinematografisë (ASHK) është një institucion kombëtar, i pavarur dhe me karakter kulturor, që bashkon profesionistët e industrisë së filmit brenda dhe jashtë vendit. Frymezuar nga modelet më të mira evropiane, si César në Francë dhe David di Donatello në Itali, Akademia synon promovimin, mbrojtjen dhe vlerësimin e meritokracisë në kinematografinë shqiptare.

The Albanian Academy of Cinematography

The Albanian Academy of Cinematography (ASHK) is an independent national cultural institution that brings together film industry professionals from Albania and abroad. Inspired by leading European models, such as the César in France and the David di Donatello in Italy, the Academy is dedicated to promoting, protecting, and recognizing meritocracy in Albanian cinematography.

01 **PËRZGJEDHJA E SEKTORIT**

Gjatë aplikimit duhet të përzgjidhni sektorin e industrisë së filmit ku bëni pjesë. Nëse veproni në disa fusha (p.sh. Regjisor dhe Producent), sistemi ju mundëson të zgjidhni më shumë se një sektor për të reflektuar saktë profilin tuaj.

SECTOR SELECTION

During the application process, you must select the film industry sector you belong to. If you work across multiple fields (e.g., Director and Producer), the system allows you to select more than one sector to accurately reflect your professional profile.

02 **LETRA E MOTIVIMIT**

Një tekst i shkurtër, ku shprehni kërkesën dhe motivimin tuaj për t'u bërë pjesë e Akademisë.

MOTIVATION LETTER

A short statement expressing your interest and motivation for becoming a member of the Academy.

03

KRITERI GJEOGRAFIK
Anëtarësimi është i hapur për të gjithë kineastët dhe profesionistët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë brenda territorit, si dhe për ata në diasporë (Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi dhe kudo në botë).

GEOGRAPHICAL ELIGIBILITY
Membership is open to all Albanian filmmakers and film professionals living and working within Albania, as well as those in the diaspora (Kosovo, North Macedonia, Montenegro, and anywhere else in the world).

04

JETËSHKRIMI PROFESIONAL (CV)
Ngarkimi i një CV-je personale në format PDF, ku listohet filmografia, rolet dhe kontributi juaj specifik në projekte kinematografike.

PROFESSIONAL BIOGRAPHY (CV)
Upload a personal CV in PDF format, listing your filmography, roles, and specific contributions to film projects.

05

REKOMANDIMI PROFESIONAL
Ngarkimi i një letre rekomandimi nga një prej shoqatave kinematografike aktive dhe të njohura që funksionojnë në Shqipëri.

PROFESSIONAL RECOMMENDATION
Upload a letter of recommendation from one of the active and recognized film associations operating in Albania.

06

KUOTA E ANËTARËSIMIT
Pagesa e një kuote simbolike vjetore prej 15 Euro, e cila shërben për mirëmbajtjen e platformës dhe shërbimet ndaj anëtarëve.

MEMBERSHIP FEE
Payment of a symbolic annual membership fee of €15, which contributes to the maintenance of the platform and services provided to members.

07

KODI I ETIKËS
Pranim i rregullores dhe Kodit të Etikës së Akademisë.

Përtej statusit prestigjioz, anëtarësimi në Akademi ofron avantazhe konkrete që prekin anën profesionale, rrjetëzimin (networking) dhe aksesin ekskluziv në evente.

CODE OF ETHICS
Acceptance of the Academy's regulations and Code of Ethics.

Exclusive Benefits and Advantages Beyond its prestigious status, membership in the Academy offers tangible benefits that enhance professional development, networking opportunities, and exclusive access to events.

01 E DREJTA E VOTËS DHE VENDIMMARRJES

VOTIMI PËR FESTIVALIN KOMBËTAR

Ju bëheni pjesë e trupës elitare, që me votën tuaj sovrane dhe të fshehtë vendos për fituesit e Çmimeve të Mëdha të Kinematografisë Shqiptare. Vota juaj ka peshë profesionale!

VOTING AND DECISION-MAKING RIGHTS

NATIONAL FILM FESTIVAL VOTING

You become part of the select body of professionals whose sovereign and secret vote determines the winners of the major Albanian Film Awards. Your vote carries professional weight!

02 KARTA E AKADEMISË (AKSES DHE BADGE ZYRTAR)

KARTË DIGJITALE DHE FIZIKE

Do të pajiseni me Kartën e Anëtarit me foto, emër dhe profesion. Kjo kartë shërben si Badge Zyrtar.

HYRJE NË FESTIVAL

Hyrje të lirë në të gjitha netët e Festivalit Kombëtar të Filmit Shqiptar.

AKSES KINEMATOGRAFIK

Akses pa pagesë ose me tarifa të reduktuara në të gjitha aktivitetet që financohen nga QKK (festivale, konferenca, panele, masterklasa).

ACADEMY CARD (OFFICIAL ACCESS & BADGE)

DIGITAL AND PHYSICAL CARD

You will receive a Membership Card featuring your photo, name, and profession. This card serves as your Official Badge.

FESTIVAL ACCESS

Free admission to all evenings of the Albanian National Film Festival.

CINEMATIC ACCESS

Free or discounted access to all QKK-funded activities, including festivals, conferences, panels, and masterclasses.

03 EKSKLUZIVITETI NË FESTIVALIN KOMBËTAR

FTESË VIP & SETI I MIRËSEARDHJES

Ftesë e garantuar për ceremonitë e hapjes dhe ndarjes së çmimeve, së bashku me setin special të festivalit (çantë e personalizuar, katalog zyrtar, program dhe merchandising).

ZONA VIP LOUNGE

Akses i dedikuar në hapësirën VIP Lounge të Festivalit — vendi ideal për takime formale, intervista dhe diskutime me kolegë e të ftuar ndërkombëtarë.

EXCLUSIVITY AT THE NATIONAL FILM FESTIVAL

VIP INVITATION & WELCOME KIT

A guaranteed invitation to the opening and awards ceremonies, along with the festival's special welcome kit (personalized bag, official catalogue, program, and merchandise).

VIP LOUNGE ACCESS

Dedicated access to the Festival's VIP Lounge — the ideal setting for formal meetings, interviews, and discussions with colleagues and international guests.

04

RRJETËZIMI PROFESIONAL DHE PUNËSIMI

PLATFORMA "CINE-MATCH" / RRJETI I STAFIT
Profili juaj do të jetë pjesë e një baze të dhenash të mbrojtur. Do të merrni njoftime ekskluzive para të tjerëve për nevojat e produksioneve të reja (shqiptare dhe bashkëprodhime ndërkombëtare) për staf teknik, artistik apo menaxhues.

QASJE NË THIRRJET E QKK-SË
Informim i vazhdueshëm dhe në kohë reale për vendimet e QKK-së, thirrjet për aplikim dhe mundësitë e fondeve të huaja (Creative Europe, Eurimages, etj.).

PASQYRA E SUKSESIT
Buletin periodik informativ lidhur me rrugëtimin, pjesëmarrjen dhe sukseset e filmave shqiptarë nëpër botë.

PROFESSIONAL NETWORKING AND EMPLOYMENT

"CINE-MATCH" PLATFORM / CREW NETWORK
Your profile will become part of a secure database. You will receive exclusive early notifications about staffing needs for new productions (Albanian and international co-productions), including technical, creative, and managerial positions.

ACCESS TO QKK CALLS
Continuous, real-time updates on QKK decisions, calls for applications, and international funding opportunities (Creative Europe, Eurimages, etc.).

SUCCESS OVERVIEW
A periodic newsletter featuring updates on the journey, participation, and achievements of Albanian films around the world.

05

MUNDËSI TË MËTEJSHME

SHFAQJE TË DEDIKUARA (SCREENINGS)
Qasje në platformën online të Akademisë për të parë filmat në garë përpara votimit (shfaqje të mbyllura vetëm për anëtarët).

MASTERKLASA NDËRKOMBËTARE
Mundësi ekskluzive për të ndjekur sesione trajnimi me kineastë të huaj të ftuar nga Akademia në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, festivale kombëtare dhe ndërkombëtare që realizohen në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, etj.

FURTHER OPPORTUNITIES

EXCLUSIVE SCREENINGS
Access to the Academy's online platform to watch films competing for awards ahead of the voting process (private screenings exclusively for members).

INTERNATIONAL MASTERCLASSES
Exclusive opportunities to attend training sessions with international filmmakers invited by the Academy, in collaboration with the National Center of Cinematography and national and international festivals held in Albania, Kosovo, North Macedonia, and beyond.

FILMI I GJATË I KARRIERËS


FEATURE
FILM


JURIA
JURY

Blerta Zeqiri është regjisore kosovare me mbi dy dekada përvojë në industrinë e filmit. Që nga viti 2012, ajo është anëtare e Akademisë Evropiane të Filmit dhe është nderuar nga shteti francez me titullin Kalorëse e Urdhrit të Arteve dhe Letërsisë. Filmat e saj janë shfaqur në festivale të rëndësishme ndërkombëtare dhe kanë marrë vlerësime e çmime. Kthimi ishte filmi i parë kosovar i përzgjedhur në Festivalin e Filmit Sundance, ku fitoi çmimin kryesor në vitin 2012. Ajo ka realizuar gjithashtu filmin e parë kosovar që trajton të drejtat LGBT, Martesa, i cili u prit mirë nga kritikët ndërkombëtarë dhe publiku vendas. Puna e saj është e fokusuar në tema sociale dhe njerëzore, duke sjellë në ekran histori që pasqyrojnë realitetin bashkëkohor të Kosovës. Përmes filmave të saj, Zeqiri ka kontribuar në prezantimin e kinematografisë kosovare në skenën ndërkombëtare. Në vitin 2023, Zeqiri u emërua Drejtore e Qendrës Kinematografike të Kosovës, ku vazhdon të mbështesë dhe promovojë industrinë e filmit.

Blerta Zeqiri is a Kosovar film director with over two decades of experience in the film industry. Since 2012, she has been a member of the European Film Academy, and she has been honored by the French state as a Chevalier de l'Ordre des Arts et des Lettres. Her films have traveled widely on the international festival circuit, earning recognition and awards along the way. Her short film Kthimi (The Return) was the first Kosovar film ever selected for the Sundance Film Festival—one of the world's leading film festivals founded by Robert Redford—where it won the main award in 2012. Blerta also directed Kosovo's first film to address LGBT rights. Her feature film Martesa (The Marriage) was warmly received by both international critics and local cinema audiences. In 2023, she was appointed Director of the Kosovo Cinematography Center for a four-year term, where she continues to work on supporting and promoting the country's film industry.



Blerta Zeqiri

Me një karrierë në letërsi dhe reklamë, filloi të shkruante skenarë pasi fitoi konkursin e HBO-së në Festivalin e Filmit në Toronto me projektin The Human Torch. Debutimin si regjisor e bëri me Half Shaved (2013), i cili fitoi çmime dhe u shfaq premierë në festivale të shumta. Ndërsa drejtonte filma të tjerë të shkurtër, vazhdoi të shkruante skenarë për filma të tjerë artistikë. Filmi i tij i parë u shfaq premierë në Festivalin e fundit të Filmit në Venecia, ku mori dy çmime.

Filmografia
El año nuevo que nunca llegó (2024, D'A 2025), The Merry-Go-Round (film i shkurtër, 2020), The Christmas Gift (film i shkurtër, 2018), Spid (film i shkurtër, 2016), Negruzzi 14 (film i shkurtër, 2016), Half Shaved (film i shkurtër, 2013).

With a career in literature and advertising, he began writing screenplays after winning the HBO competition at the Toronto Film Festival with the project The Human Torch. He made his directorial debut with Half Shaved (2013), which won awards and premiered at numerous festivals. While directing other short films, he continued writing scripts for other feature films. He premiered his first film at the last Venice Film Festival, where he received two awards.

Filmography
El año nuevo que nunca llegó (2024, D'A 2025), The Merry-Go-Round (short film, 2020), The Christmas Gift (short film, 2018), Spid (short film, 2016), Negruzzi 14 (short film, 2016), Half Shaved (short film, 2013).



Bogdan Mureșanu

Haig Zacharian është kompozitor dhe Artist i Meritуar. Ai u diplomua në degën e kompozicionit në Institutin e Lartë të Arteve, në vitin 1974. Pas një periudhe në lëvizjen artistike amatore, punoi si mësues në shkollën artistike në Durrës dhe në Akademinë e Arteve në Tiranë, ku drejtoi edhe katedrën e teorisë dhe kompozicionit. Krijimtaria e tij përfshin këngë, vepra vokale e instrumentale, orkestrale, skenike dhe muzikë filmi. Zaharian bashkëpunoi në 27 filma me kineastë të njohur të Kinostudios "Shqipëria e Re". Ndër veprat e tij më të spikatura janë kolonat zanore të filmave "Dollia e dasmës sime" (1978), "Njeriu i mirë" (1982), "Dora e ngrohtë" (1983) dhe "Taulanti kërkon një motër" (1984). Veprimtaria e tij e pasur e bëri një nga emrat e rëndësishëm të muzikës shqiptare, veçanërisht në fushën e muzikës së filmit.

Haig Zacharian is a composer and a Merited Artist. He graduated in composition from the University of Arts (then the Higher Institute of Arts) in 1974. After a period in the amateur artistic movement, he worked as a teacher at the art school in Durrës and at the University of Arts in Tirana, where he also headed the department of theory and composition. His creativity includes songs, vocal and instrumental works, orchestral pieces, stage productions, and film music. Zaharian collaborated on 27 films with well-known filmmakers from the "New Albania" Film Studio. Among his most prominent works are the soundtracks for the films Dollia e dasmës sime (1978), Njeriu i mirë (1982), Dora e ngrohtë (1983), and Taulanti kërkon një motër (1984). His extensive body of work made him one of the most prominent names in Albanian music, especially as a film composer.



Haig Zacharian

Rajmonda Bulku është një nga aktoret më të njohura të kinematografisë dhe teatrit shqiptar. E diplomuar për aktrim në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë, ajo ka interpretuar në dhjetëra filma dhe shfaqje teatrore. Ndër rolet e saj më të spikatura janë në filmat Zonja nga qyteti, Nusja dhe Shtetrrethimi, Ballë për Ballë, Të Paftuarit, Vdekja e Kalit, Tirana, Viti Zero dhe Amsterdam Express. Me një karrierë të gjatë dhe të suksesshme, Bulku mbetet një nga figurat e rëndësishme të artit skenik shqiptar.

Rajmonda Bulku is one of the most renowned actresses in Albanian cinema and theatre. After graduating with a degree in acting from the Higher Institute of Arts in Tirana, she went on to star in dozens of films and theatrical productions. Her most notable film credits include Zonja nga Qyteti, Nusja dhe Shtetrrethimi, Ballë për Ballë, Të Papriturat, Vdekja e Kalit, Tirana, Viti Zero, and Amsterdam Express. Throughout her long and illustrious career, Bulku has remained a prominent figure in the Albanian performing arts.



Rajmonda Bulku

Ylljet Aliçka (lindur më 1951) është shkrimtar dhe diplomat shqiptar, i cili ka shërbyer si Ambasador i Shqipërisë në Francë, Monako, Portugali dhe pranë UNESCO-s. Aktualisht është anëtar i Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë. Është diplomuar në Shkencat e Natyrës dhe ka punuar si mësues, përpara se të bëhej Oficer i Komunikimit pranë Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë dhe më pas të ndiqte karrierën diplomatike. Ka botuar përmbledhje me tregime të shkurtra dhe romane, si dhe skenarë të bazuar në veprat e tij, ndër të cilët Slogans, një film franko-shqiptar i vlerësuar në Festivalin e Filmit në Kanë dhe fitues i Çmimit të Artë në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Tokio në vitin 2011. Ndër veprat e tij janë edhe Kronika shqiptare (2006) dhe Të mërguarit (2007). Librat e tij janë botuar në frëngjisht, polonisht, çekisht, norvegjisht, italisht dhe anglisht.

Ylljet Aliçka (born in 1951) is an Albanian writer and diplomat who has served as Albania's Ambassador to France, Monaco, Portugal and UNESCO. He is currently a member of the General Assembly of the Council of Albanian Ambassadors. He graduated in Natural Sciences and worked as a teacher before joining the Delegation of the European Union in Tirana as a Communication Officer and later pursuing a diplomatic career. He has published collections of short stories and novels, as well as screenplays based on his books, including *Slogans*, a French-Albanian film awarded at the Cannes Film Festival and winner of the Golden Prize at the Tokyo International Film Festival in 2011. His other works include *The Albanian Chronicle* (2006) and *The Expatriates* (2007). His books have been published in French, Polish, Czech, Norwegian, Italian and English.



Ylljet Aliçka

2014

93 min

AMSTERDAM
EXPRESS

AMSTERDAM EXPRESS
FATMIR KOÇI

Skenari / Writer
Fatmir Koçi
Jonathan Preece
Aktorët / Cast
Blerim Destani
Flonja Kodheli
Agim Biberi
Rajmonda Bulku
Producent / Producers
Fatmir Koçi
Fotografia / Cinematography
Enzo Brandner
Montazhi / Editor
Max Vonk
Inxhinier/e zëri / Sound Engineer
Jaim Sahuleka
Skenografia / Production Design
Oriana Kamberi
Kostumografia / Costume Design
Stela Laknori
Muzika / Music
Jonathan Preece

Një emigrant i ri shqiptar gjendet në një situatë të pasigurt në Amsterdam, mes premtimit dhe joshjes së qytetit të pasur, kërcënimeve nga trafikantë të pamëshirshëm shqiptarë të drogës dhe qenieve njerëzore, si dhe martesës së tij fiktive me një vajzë holandeze. Në qendër të gjithë kësaj qëndron dashuria e vërtetë për MARTËN, në vendin e tij të varfër dhe të prapambetur. BEKIMI, 30 vjeç, është i gatshëm të bëjë gjithçka për të fituar shpejt para. Por, në vend të kësaj, ai kthehet në vendin e tij duarbosh, pasi jep edhe eurot e fundit për të shpëtuar një vajzë të re në vitrinat e lagjes së dritave të kuqe.

A young Albanian immigrant is precariously caught in Amsterdam, torn between the city's glittering promises, threats from ruthless Albanian drug and human traffickers, and a sham marriage to a young Dutch woman. At the heart of it all lies his true love for MARTA, back in his poor and left-behind homeland. BEKIM, 30, is willing to do whatever it takes to make fast money. Instead, he returns home empty-handed after giving his last euros to save a young woman behind the windows of the Red Light District.



Shtëpia e prodhimit / Production Company
KKOÇI PRODUCTIONS

BOLERO NË VILËN E PLEQVE
SPARTAK PECANI

2019


95 min

BOLERO IN THE ELDERS' VILLA

SKENARI / WRITER
Lindita Fejzaj
Spartak Pecani
AKTORËT / CAST
Robert Ndrenika
Margarita Xhepa
Afrim Muçaj
Gentiana Ramadani
Olta Gixhari
PRODUCENT / PRODUCERS
Agim Halili
FOTOGRAFIA / CINEMATOGRAPHY
Latif Hasolli
MONTAZHI / EDITOR
Endri Sina
Inxhinier/e zëri / Sound Engineer
Alban Osmaj
KOSTUMOGRAFIA / COSTUME DESIGN
Gerta Oparaku
MUZIKA / MUSIC
Endri Sina

Irena, një infermiere e re, jeton në një qytezë të vogël. Marrëdhënia intime me shoqen e saj, Anën, e detyron të largohet në panik nga qyteti dhe të shpërngulet në Tiranë, ku kujdeset për një çift të moshuarish. E vetmuar dhe pa rrugëdalje, Irena gjen ngrohtësi në vilën e pleqve. Tingujt e Boleros dhe Irena bëhen dëshmitarë të heshtur të një letërkëmbimi të pazakontë mes çiftit. Përplasja mes dy botëve – botës së të moshuarve të dashuruar deri në fund të jetës dhe botës së fëmijëve të tyre që nuk dinë se çfarë kërkojnë – e shtyn Irenën të kuptojë vlerën e vërtetë të dashurisë.

Irena, a young nurse, lives in a small town. Her intimate relationship with her friend Ana forces her to flee the town in panic and move to Tirana, where she takes care of an elderly couple. Lonely and with nowhere else to turn, Irena finds warmth in the couple's villa. The sounds of Bolero and Irena herself become silent witnesses to an unusual correspondence between the couple. The clash between two worlds—the world of the elderly couple, who remain in love until the end of their lives, and the world of their children, who do not know what they want—leads Irena to understand the true value of love.



Shtëpia e prodhimit / Production Company
ECLIPSE SA
FILM PRODUCTION

2015

78 min

KROM
BUJAR ALIMANI

CHROMIUM

Një djalë adoloshent jeton në një provincë të largët të Shqipërisë, ku vihet në provë nga vështirësitë sociale. Atij i duhet të bëjë disa zgjedhje dhe të marrë vendime, që do të influencojnë karakterin e tij të ardhshëm.
I gjendur mes dashurisë së ashpër të nënës dhe brishtësisë ledhatuese të mësueses, pavarësisht dëmtimeve, ai gdhend brenda vetes njeriun, i cili do të jetë i hapur ndaj të tjerëve, duke lënë mënjanë paragjykimet e shoqërisë ku jeton.

A teenage boy lives in a remote province of Albania, where he is tested by social hardships. He must make choices and decisions that will shape his future character.
Caught between his mother's harsh love and his teacher's tender affection, despite the wounds he endures, he shapes within himself the man he will become—open to others and willing to set aside the prejudices of the society in which he lives.



Skenari / Writer
Bujar Alimani
Aktorët / Cast
Fredjon Ruçi
Klodjana Keco
Mirela Naska
Kasem Hoxha
Producent / Producers
Tefta Bejko
Fotografia / Cinematography
Ilias Adamis
Montazhi / Editor
Bonita Papastathi
Inxhinier/e zëri / Sound Engineer
Elvis Ikonomi
Kostumografia / Costume Design
Stela Laknori
Muzika / Music
Pjeter Gaci

Shtëpia e prodhimit / Production Company
90 PRODUCTION

KËTU VALLËZOHET ME HIJET
PLUTON VASI

2024

98 min

DANCING WITH THE SHADOWS

Skenari / Writer
Bashkim Hoxha
Aktorët / Cast
Karafil Shena
Rovena Lule Kuka
Neritan Liçaj
Eri Shuka
Producent / Producers
Vjollca Dedei
Fotografia / Cinematography
Spartak Papadhimitri
Montazhi / Editor
Gjergji Pano
Inxhinier/e zëri / Sound Engineer
Darko Spadsovski - Packi
Skenografia / Production Design
Spartak Papadhimitri
Kostumografia / Costume Design
Taulant Pustina
Muzika / Music
Haig Zacharian

Shtëpia e prodhimit / Production Company
ARTFILM P&D

Flora, një gazetare e re me origjinë shqiptaro-austriake, mëson historinë e familjes dhe të vetes nga hije të së shkuarës. Ziguri, një ish-punonjës i Sigurimit të Shtetit, sjell një sekret të të shkuarës, një marrëdhënie për jetë a vdekje, e ngre dilema që kërkon zgjedhje sot. Miriami, nëna e Florës sjell statuse psikologjike të marrëdhënieve midis njerëzve dhe me shtetin, ku ndërthuren dramat e secilit personazh. Individi, shteti, dashuria, mbijetesa në një kohë me përgjime, vrasje, përdhunime, përndjekje. Gjithçka përplaset me dashurinë për jetën. Hijet e së shkuarës vallëzojnë lirshëm nga njëra kohë në tjetrën.

Flora, a young journalist of Austrian-Albanian origin, learns the story of her family and herself from shadows of the past. Zigur, a former member of the secret police reveals a secret of that time, a revelation of death and life that results in a dilemma of today's choice. Miriam, Flora's mom brings the psychological statuses of relations among people and with the state, with all its atrocities resulting with a dilemma of today's choice. The individual, the state, the love, the survival in a time of surveillance, killing, rape, persecution. Everything faces the love for life. The shadows of the past dance freely from one time to the other.



2020

100 min

MY LAKE

LIQENI IM
GJERGJ XHUVANI

Kristoja, një djalë i ri, jeton në një fshat buzë liqenit të mrekullueshëm të Prespës, një sipërfaqe ujore e ndarë mes kufijve të tri vendeve ballkanike: Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë. Për të mbajtur familjen, ai është kthyer në një kontrabandist të marihuanës, duke përdorur varkën e tij dhe njohuritë mbi ujërat e liqenit për të transportuar pako droge nga ana shqiptare në atë maqedonase.

Young Kristo lives in a village at the edge of gorgeous Lake Prespa, a body of water divided on the borders of three Balkan countries Albania, Macedonia and Greece. In order to support his family, Kristo has become a small-time marijuana smuggler, using his boat and knowledge of the lake waters to transport drug packages from the Albanian to the Macedonian side.



Skenari / Writer
Gjergj Xhuvani
Aktorët / Cast
Ariton Pollozhani
Vedran Zivolic
Elja Zaharia
Tristan Halilaj
Luiza Xhuvani
Producent / Producers
Dritan Huqi
Fotografia / Cinematography
Dimo Popov
Montazhi / Editor
Juan Gambino
Inxhinier/e zëri / Sound Engineer
Mirko Fabbri
Kostumografia / Costume Design
Stela Laknori
Muzika / Music
Rosario Di Bella

Shtëpia e prodhimit / Production Company
ON FILM PRODUCTION

LUNA PARK
FLORENC PAPAS

2024


105 min

LUNA
PARK

Skenari / Writer
Florenc Papas
Aktorët / Cast
Adriana Matoshi
Orion Jolldashi
Nik Xhelilaj
Flonja Kodheli
Producent / Producers
Dritan Huqi
Fotografia / Cinematography
Simos Sarketzis
Montazhi / Editor
Federica Forcesi
Inxhinier/e zëri / Sound Engineer
Jacopo Manzo
Kostumografia / Costume Design
Stela Laknori
Muzika / Music
Matej Merlic

Në Shqipërinë e vitit 1997, Mira, përpiqet të rris djalin e saj adoleshent, Tonin, si një nënë e vetme, ndërsa i shoqi ka vite i larguar në Greqi. Me shpresën për një jetë më të mirë, ajo investon të gjitha paratë e saj në një skemat e asaj kohe, e bindur se kjo do t'ua ndryshojë të ardhmen. Ndërkohë, Toni i kalon ditët me shoqen e tij më të mirë, Sarën, e cila është gati të shpërngulet përgjithmonë në Greqi. Ndërsa në të gjithë vendin skemat dështojnë, Mira dhe Toni kuptojnë se nuk kanë zgjidhje tjetër veçse të ikin, para se të jetë tepër vonë.

In 1997 Albania, Mira, a single mother, struggles to raise her teenage son, Toni, as the country falls into chaos. Hoping for a better life, she invests all her money in a risky scheme, believing it will change their future after becoming involved with a wealthy investor running the scheme. Meanwhile, Toni spends his days with his best friend, Sara, who is about to leave for Greece, making him feel even more lost. As the country collapses into violence, Mira and Toni realize they have no choice but to run, before it's too late.



Shtëpia e prodhimit / Production Company
ON FILM PRODUCTION

2022

99 min

NJË FILXHAN KAFE DHE KËPUCË TË REJA VESHUR

GENTIAN KOÇI

A CUP OF COFFEE
AND NEW SHOES ON

Dy vëllezër binjakë, identikë e të pandashëm, të shurdhër që nga lindja, zbulojnë, rreth të dyzetave, se për shkak të një sëmundjeje gjenetike do të verbohen progresivisht dhe në mënyrë të pakthyeshme. Teksa zhyten ngadalë në një errësirë të padurueshme e të heshtur, pa qenë më në gjendje të shohin botën dhe njëri-tjetrin, dy vëllezërit duhet të marrin një vendim të vështirë.

Two identical, inseparable twin brothers, deaf since birth, discover in their forties that, due to a genetic disease, they will progressively and irreversibly lose their sight. As they slowly descend into an unbearable, silent darkness, no longer able to see the world or each other, the two brothers must make a difficult decision.



Skenari / Writer
Gentian Koçi
Aktorët / Cast
Edgar & Rafael Morais
Drita Kabashi
Producent / Producers
Gentian Koçi
Blerina Hankollari
Fotografia / Cinematography
Ilias Adamis
Montazhi / Editor
Myrto Karra
Inxhinier/e zëri / Sound Engineer
Xenofontas Kontopoulos
Skenografia / Production Design
Emir Turkeshi Gramo
Kostumografia / Costume Design
Emir Turkeshi Gramo

Shtëpia e prodhimit / Production Company
ARTALB FILM PRODUCTIONS

PIKË UJI
ROBERT BUDINA

2024

90 min


WATERDROP

Skenari / Writer
Robert Budina
Doruntina Basha
Aktorët / Cast
Gresa Pallaska
Arben Bajraktaraj
Adem Karaga
Gerhard Koloneci
Klodiana Keco
Producent / Producers
Sabina Kodra
Fotografia / Cinematography
Marius Panduru
Montazhi / Editor
Enrico Giovanonne
Inxhinier/e zëri / Sound Engineer
Roberto Remorino
Costume Design
Emir Turkeshi
Muzika / Music
Marius Leftarache

Shtëpia e prodhimit / Production Company
ERAFILM

Aidës dyzet e pesë vjeç, funksionare në bashkinë e një qyteti të vogël në Jug të Shqipërisë, buzë liqenit të Ohrit, i duhet të luftojë me ngrehinën e një sistemi korruptiv, pjesë e të cilit është edhe ajo vetë, kur Marku i biri adoleshent rrezikon dënimin me burg, për përdhunimin e një shoqeje të klasës.

Aida, a 45-year-old municipal official in a small town on the shores of Lake Ohrid in southern Albania, is forced to confront the corrupt system she is herself a part of when her teenage son, Marku, faces a possible prison sentence for raping a female classmate.



2019

97 min

THE UNFINISHED
PORTRAIT

PORTRETI I PAMBARUAR
NAMIK AJAZI

Ngjarjet zhvillohen në Tiranën e izoluar të viteve '70-'80. Arturi, një student i talentuar i arteve, bie në dashuri me Clara Bellinin, vajzën e një diplomati të lartë italian. Kjo romancë bëhet shpejt një "dashuri e pamundur", duke i vënë të dy të rinjtë përballë presionit dhe persekutimit të egër të Sigurimit të Shtetit.

The story takes place in the isolated Tirana of the 1970s and 1980s. Artur, a talented art student, falls in love with Clara Bellini, the daughter of a senior Italian diplomat. Their romance quickly becomes an "impossible love," placing both young people under the pressure and brutal persecution of the State Security Service.



Skenari / Writer
Ruzhdi Pulaha
Aktorët / Cast
Antonio Kodrinaj
Beatrice Aiello
Remo Girone
Marta Gastini
Producent / Producers
Namik Ajazi
Fotografia / Cinematography
Nino Celeste
Montazhi / Editor
Mauro Bonani
Inxhinier/e zëri / Sound Engineer
Gianfranco Tortora
Skenografia / Production Design
Fatbardh Marku
Kostumografia / Costume Design
Gerta Oparaku
Muzika / Music
Aleksandër Peçi

Shtëpia e prodhimit / Production Company
MEDIAVISION

SHTATË DITË
ERION BUBULLIMA

2016

90 min

SEVEN DAYS

Skenari / Writer
Genc Përmeti
Aktorët / Cast
Jonida Vokshi
Denard Xhillari
Niada Saliasi
Visjan Ukcenaj
Ermal Mamaqi
Producent / Producers
Genc Përmeti
Fotografia / Cinematography
Rojald Elezaj
Montazhi / Editor
Erion Bubullima
Muzika / Music
Genti Lako

Lana braktiset nga i fejuari vetëm shtatë ditë përpara se prindërit e saj të vijnë për vizitë nga Greqia. Gjatë kësaj jave të ethshme, Lana rilidhet me ish-të dashurit e saj, me shpresën për të gjetur një zëvendësues të mundshëm.

Lana is abandoned by her fiancee only seven days before her parents are set to come and visit from Greece. During this frantic week, Lana reconnects with her old boyfriends hoping to find a possible substitute.



Shtëpia e prodhimit / Production Company
SKA-NDAL SH.P.K.

